VENDIM
Nr. 56, datë 25.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 2.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 15 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria "Vodafone Albania" sh.a.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj
Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 30, 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet e çështjes rezulton se pas kontrollit të ushtruar në shoqërinë "Vodafone Albania" sh.a. nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore (*DRT*) të Tatimpaguesve të Mëdhenj është mbajtur raportkontrolli i datës 9.6.2015, në bazë të të cilit është nxjerrë akti administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me nr. 3339/6 Prot., datë 9.6.2015, sipas të cilit ajo duhet të paguajë detyrimet tatimore së bashku me gjobat në vlerën 293.595.809 lekë.

2. Ndaj këtij akti administrativ shoqëria "Vodafone Albania" sh.a. (kërkuesja) ka ushtruar ankim pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor (*DAT*) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Kjo e fundit, me vendimin nr. 21871/3, datë 12.10.2015, ka vendosur: "*Refuzimin e ankimit për shkak se nuk është paguar apo nuk është vënë garanci bankare për detyrimin e plotë tatimor objekt ankimi (kamatëvonesat e TVSH-së për periudhën 2011/2012, në shumën 5.075.734 lekë) sipas njoftim vlerësimi nr. 3339/6 Prot., datë 9.6.2015, nxjerrë nga DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj*", me argumentimin se në sistemin informatik konstatohet se ndaj shoqërisë është llogaritur edhe kamatëvonesë për detyrimin për TVSH-në për periudhën dhjetor 2011, në shumën 5.075.734 lekë.

3. Kërkuesja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt shfuqizimin e akteve të mësipërme administrative.

4. Gjatë gjykimit nga ana e palëve të paditura është kërkuar në gjykim nxjerrja e çështjes jashtë

juridiksionit gjyqësor, me pretendimin se akti administrativ Njoftim Vlerësimi nuk mund të merret në shqyrtim nga gjykata në kushtet kur ai nuk është marrë më parë në shqyrtim nga organi administrativ epror, pasi pala paditëse në gjykim (kërkuesja) i është drejtuar organit administrativ pa plotësuar detyrimin ligjor të kryerjes së pagesës së detyrimit.

5. Me vendimin e datës 8.2.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesës së ngritur nga Avokati i Shtetit dhe palët e paditura, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për nxjerrjen e çështjes administrative jashtë juridiksionit gjyqësor*". Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë pala e paditur DRT-ja dhe Avokatura e Shtetit.

6. Me vendimin nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "*Prishjen e vendimit (i panumërtuar), datë 8.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes gjyqësore administrative nr. 6848/420 (31010-07196-80-2015) Regj. Themeltar, jashtë juridiksionit gjyqësor*".

II

7. ***Kërkuesja, shoqëria "Vodafone Albania" sh.a.***, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

7.1. *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë*, pasi, duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkueses gjykimin në themel të pretendimeve të saj. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, detyrimi i tatimpaguesit për të bërë ankim në organet tatimore është pagimi paraprak i detyrimit kryesor dhe kamatëvonesave. Përcaktimi i detyrimit është një tagër i organeve tatimore dhe, për rrjedhojë, ligji i referohet shumës së përcaktuar nga tatimet. Por, nga ana tjetër, përllogaritja e kamatëvonesës nuk është një çështje subjektive e organeve tatimore, por një çështje objektive, që del nga një përllogaritje matematikore, që bëhet edhe nga vetë subjekti tatimor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me të drejtë nuk e ka marrë të mirëqenë pretendimin e palës së paditur dhe ka caktuar një ekspert kontabël për të arritur në përfundimin nëse kërkuesja ka paguar shumën e pretenduar. Sipas këtij akti rezulton se shuma që pretendohet si detyrim bazuar në të dhënat e sistemit është fiktive, dhe verbalisht nga pala e paditur është pranuar se ky problem ka lindur edhe për subjekte të tjera. Por në të kundërt me arsyetimin e gjykatës së faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kamatëvonesa e detyrimit kryesor duhet të parapaguhet në shumën e përllogaritur nga organet tatimore, pavarësisht nëse llogaritja është e drejtë apo e gabuar.

7.2. Gjykata e Lartë ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor edhe për kërkimin që ka si shkak të padisë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, ndërkohë që sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në të gjitha rastet kur pretendohet pavlefshmëria absolute e aktit, gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes. Në këto raste gjykatat janë të detyruara të shqyrtojnë çështjen dhe nuk mund ta refuzojnë atë me arsyetimin se nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë të paktën duhej të kishte urdhëruar Gjykatën Administrative që të vazhdonte shqyrtimin e çështjes për padinë me kërkesë dhe shkak ligjor pavlefshmërinë e akteve administrative.

7.3. *Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Neni 9 i ligjit nr. 49/2012 i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Lartë që të vendosë për prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit kur ato vendosin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, por nuk i kanë dhënë të drejtë për të kundërtën, pra për të prishur vendimet e faktit kur e kanë vlerësuar çështjen brenda juridiksionit. Sipas paragrafit të dytë të nenit 9, gjykata që vlerëson çështjen e juridiksionit duhet ta ketë çështjen në shqyrtim në themel. Po sipas kësaj dispozite, vendimi kundër të cilit mund të bëhet ankim i veçantë është vendimi i nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Paragrafi i tretë i nenit 9 parashikon vendimin e Gjykatës së Lartë kur konstaton se çështja është brenda juridiksionit, por nuk ka asnjë parashikim për rastet kur Gjykata e Lartë konstaton se çështja është jashtë juridiksionit. Pranimi i

ankimit të veçantë edhe në rastet kur gjykatat e faktit vlerësojnë se çështja është brenda juridiksionit gjyqësor bie në kundërshtim me rolin dhe natyrën e Gjykatës së Lartë, e cila shqyrton në shkallë të tretë çështjet për moszbatimin e ligjit ose shkelje të rënda procedurale. Përjashtimisht, Gjykata e Lartë ndërhyn, jashtë funksionit të saj të zakonshëm, për të mbrojtur të drejtat themelore procedurale të palëve në procesin gjyqësor. Në këtë kuptim, ndërhyrja e Gjykatës së Lartë nuk është e domosdoshme dhe nuk përligjet kur gjykata e faktit vlerëson se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor. Në përfundim, Gjykata e Lartë nuk duhej të pranonte gjykimin e ankimit të veçantë, por duhej të urdhëronte gjykatën administrative të vazhdonte gjykimin e themelit të çështjes.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

8. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 30.3.2016, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë me postë në datën 28.2.2017, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar të zbatueshëm sipas ligjit organik të Gjykatës deri në datën 1 mars, kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja ligjore në lidhje edhe me afatin e paraqitjes së ankimit individual.

9. Për sa i takon legjitimimit *ratione materia*, neni 131/1/f i Kushtetutës parashikon se individi mund t'i drejtohet asaj për gjykimin përfundimtar të pretendimeve për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Objekt kërkese në rastin konkret është një vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur përfundimisht nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Në kushtet kur ky vendim është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat, kërkuesja nuk ka mjet tjetër ligjor për të goditur këtë vendim. Po ashtu, pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, kërkuesja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës.

B. Lidhur me themelin e çështjes

B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë

10. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor i ka mohuar kërkueses gjykimin në themel të pretendimeve të saj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me të drejtë nuk e ka marrë të mirëqenë pretendimin e palës së paditur dhe ka caktuar një ekspert kontabël për të arritur në përfundimin nëse kërkuesja ka paguar shumën e pretenduar dhe sipas këtij akti shuma që pretendohet si detyrim bazuar në të dhënat e sistemit është fiktive. Por në të kundërt me arsyetimin e gjykatës së faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kamatëvonesa e detyrimit kryesor duhet të parapaguhet në shumën e përllogaritur nga organet tatimore, pavarësisht nëse llogaritja është e drejtë apo e gabuar. Po ashtu, sipas kërkueses, neni 9 i ligjit nr. 49/2012 i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Lartë që të vendosë për prishjen e

vendimeve të gjykatave të faktit kur ato vendosin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, por nuk i kanë dhënë të drejtë për të kundërtën, pra për të prishur vendimet e faktit kur e kanë vlerësuar çështjen brenda juridiksionit. Në zbatim të kësaj dispozite, Gjykata e Lartë nuk duhej të pranonte gjykimin e ankimit të veçantë, por të urdhëronte Gjykatën Administrative të vazhdonte gjykimin e themelit të çështjes.

11. Gjykata ka theksuar se bazuar në parimin *jura novit curia* ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 50, datë 9.5.2012; nr. 19, datë 25.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimet e kërkueses, edhe pse janë paraqitur veçmas prej saj, duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

12. Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar se termi "*gjykatë*" karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit *(shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.03.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 16, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në standardet e mësipërme dhe në rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim rezulton se kërkuesja i është drejtuar gjykatës administrative për shfuqizimin e akteve administrative në lidhje me detyrimet tatimore për vlerën e TVSH-së (përfshirë detyrimin, gjoba dhe interesa) dhe vendimit të organit administrativ që ka refuzuar ankimin administrativ. Në gjykim pala e paditur në proces ka pretenduar se kërkuesja nuk ka parapaguar detyrimet sipas parashikimeve ligjore dhe për këtë arsye ankimi administrativ nuk është marrë në shqyrtim. Për rrjedhojë është kërkuar edhe nga gjykata nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, për sa kohë që nuk është shteruar rruga administrative. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e ka rrëzuar këtë kërkim, duke arsyetuar se në rastin konkret nga provat e paraqitura nga palët dhe akti i ekspertimit kontabël rezulton se shoqëria paditëse ka paguar të gjithë detyrimin dhe kamatëvonesat që lidheshin me shumën e plotë. Sipas saj, kërkuesja i është nënshtruar edhe më parë një kontrolli tatimor, nga i cili kanë rezultuar

detyrimet dhe gjobat që ajo duhej të paguante. Pasi ka shlyer detyrimet, shoqëria ka paraqitur ankim administrativ, në përfundim të të cilit DAT-ja ka vendosur shfuqizimin e detyrimit shtesë për periudhën dhjetor 2011 dhe ka kërkuar kryerjen e rikontrollit tatimor për këtë periudhë. Në përfundim të rikontrollit (që i përket çështjes në shqyrtim) rezulton se për kërkuesen janë vendosur detyrime tatimore më të ulëta në krahasim me kontrollin e mëparshëm, të cilat shoqëria i kishte të kompensuara dhe për këtë ka paraqitur në gjykim një shkresë nga Drejtoria Tatimore Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, se nuk ka pasur detyrime të papaguara. Kjo rezulton të jetë konfirmuar edhe nga eksperti i thirrur nga gjykata dhe sipas aktit të ekspertimit rezulton se është kryer pagesa e të gjitha detyrimeve dhe kamatëpagesave për qëllime të ankimit administrativ.

15. Vendimi për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është kundërshtuar nga pala e paditur në Gjykatën e Lartë. Kolegji Administrativ, në kundërshtim me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, ka arsyetuar se ankimi administrativ nuk është ezauruar nga kërkuesja për faj të saj, sepse ka pasur dijeni lidhur me vlerësimin tatimor dhe kamatëvonesat, si dhe nuk rezulton të ketë kundërshtuar faktin e marrjes dijeni për urdhërpagesën që u përket këtyre të fundit. Po ashtu, ajo arsyeton: *"Gjykata administrative pranon sa nga përmbajtja e shkresave dhe urdhërpagesave përkatëse të lëshuara nga sistemi informatik tatimor, pala paditëse nuk ka shlyer shumën... për sa i përket kamatëvonesave sikurse rezulton nga urdhërpagesa... Por, nga ana tjetër, kjo gjykatë thjesht arsyeton se në rastin në gjykim nga provat e paraqitura nga palët dhe akti i ekspertimit kontabël, shoqëria paditëse rezulton të ketë paguar detyrimet tatimore, por pa treguar se përse nuk është shlyer edhe shuma që u përket kamatëvonesave, sikurse rezulton nga urdhërpagesa e administruar dhe pranuar si provë nga vetë gjykata".*

16. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, si dhe me standardet e vendosura prej saj, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të administruara gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë mënyrë, ajo ka dalë jashtë funksionit të saj ligjor, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

17. Lidhur me argumentin shtesë të kërkuesit, sipas të cilit Gjykata e Lartë nuk ka kompetenca të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, Gjykata çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar, pasi është në funksionin e saj të vendosë për të gjitha çështjet që lidhen me kompetencën dhe juridiksionin.

18. Lidhur me pretendimin se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e aksesit në gjykatë kur ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor edhe për kërkimin që ka si shkak të padisë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, Gjykata çmon se ky pretendim është bazuar.

19. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Lartë, referuar objektit dhe shkakut të padisë, si dhe pretendimeve të kërkuesit, ishte e detyruar të merrte në shqyrtim e të verifikonte nëse akti

administrativ ishte ose jo absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të refuzonte shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se çështja nuk ishte shqyrtuar në themel nga organi administrativ dhe se pala paditëse nuk kishte respektuar kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj